

VENDIM
Nr. 558, datë 16.8.2006

**PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË SHËRBIMIT
TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM, INSPEKTIMIT TË PËRGJITHSHËM
DHE SHIFRËS, NË MINISTRINË E BRENDSHME**

(Ndryshuar me VKM nr. 450, datë 18.7.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 63 të ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, të nenit 5/1, të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat, për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave, për punonjësit e Policisë së Shtetit, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, Inspektimit të Përgjithshëm dhe Shifrës, në Ministrinë e Brendshme, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë mujore për gradë (kolona 3), e lidhjes nr.1, është niveli i pagës së punonjësit të Policisë së Shtetit, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, Inspektimit të Përgjithshëm dhe Shifrës, në Ministrinë e Brendshme, në përputhje me gradën që ka fituar.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolonat 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 e 15), të lidhjes nr.1, jepet sipas funksioneve, të përcaktuara në këtë lidhje.

4. Punonjësit e Policisë së Shtetit, të cilët, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë nivele pagash më të larta se niveli i përcaktuar në lidhjen nr.1 të këtij vendimi, të vazhdojnë të paguhen me pagën ekzistuese, por jo më shumë se dy vjet.

5. Vendimi nr. 333, datë 29.5.2003 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Efektet financiare për vitin 2006, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen e pagave në buxhetin e Ministrisë së Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

(Ndryshuar me VKM nr. 450, datë 18.7.2007)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit, SH.K.B, Inspektimit të Përgjithshëm dhe Shifrës në Ministrinë e Brendshme

[illegible]